



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 09.08.2019

Për: Operatorin ekonomik “Erisoni Company” shpk
Adresa: Njesia Bashkiake nr. 7, Rruga Shefqet Musaraj, Pallati nr. 3, Kati I-re.

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur” Loti II: “Blerje bojëra për printera, fotokopje dhe plotera”.

Referenca e procedurës: REF-20483-05-05-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Loti II: “Blerje bojëra për printera, fotokopje dhe plotera”.

Fondi limit loti i dytë: 14,583,333 (katërbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Afati i dorëzimit të mallit: Artikujt duhet të dorëzohen në magazinën e Bashkisë Tiranë, nga lidhja e kontratës për një periudhë kohore një vit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 17.06.2019, ora 11.00

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 19 datë 13 Maj 2019.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesi ekonomik me vlerën përkatëse të ofruar si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “Infosoft Office” shpk **NUIS J62426002Q**

Vlera e ofertës – 3.847.951,77 (tre milion e tetëqind e dyzet e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një presjeshtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “Interlogistic” shpk **NUIS K21605003M**

Vlera e ofertës – 8.504.169,51 (tetë milion e pesëqind e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëtë presje pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” shpk **NUIS K81503063B**

Vlera e ofertës – 9.676.417,3 (nëntë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë presje tre) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “Erisoni Company” shpk **NUIS K92006501A**

Vlera e ofertës – 9.387.000 (nëntë milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “Eldi Qafmolla” pf **NUIS L021160250**

Vlera e ofertës – 11.218.150 (njëmbëdhjetë milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

6. Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” shpk **NUIS J72124001N**

Vlera e ofertes- 11.500.468,68 (njëmbëdhjetë milion e pesëqind e mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë presje gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh

7. Operatori ekonomik “Adastra” shpk **NUIS L41826018M**

Vlera e ofertes- 11.800.000 (njëmbëdhjetë milion e tetëqind e mijë) lekë pa tvsh

8. Operatori ekonomik “Read 2000 ” shpk **NUIS L71718029K**

Vlera e ofertes- 12.650.000 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

9. Operatori ekonomik “Adenis Kastrati” shpk **NUIS L51611004I**

Vlera e ofertes- 10.488.888 (dhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh.

Janë s’kualifikuar operatorët ekonomikë si më poshtë vijon:

1. **Operatori ekonomik “Infosoft Office” shpk**
2. **Operatori ekonomik “Interlogistic” shpk**
3. **Operatori ekonomik “Eldi Qafmolla”Pf**
4. **Operatori ekonomik “Adenis Kastrati” shpk**

1. Operatori ekonomik «Infosoft Office» shpk është s’kualifikuar për arsyet e mëposhtme:

- **Mostrat e dorëzuara nga OE “Infosoft Office” nuk plotësojnë kriteret sipas pikës 2.3.3 në DST dhe specifikimeve teknike “Bojërat duhet të jenë origjinale dhe jo kompatibël, të ricikluar, të rimbushur dhe të kenë pullën e garancisë së prodhuesit të pajisjeve. Te jene të ambalazuara në konfeksione të reja, të pahapura e të padëmtuara me elementet perkates të sigurisë/ vulë origjinaliteti. Emri i prodhuesit duhet të jetë i stampuar si në kutinë e bojës, në pullën e sigurisë si dhe kartrixhe. Numri serial i kutisë duhet të jetë i njëjtë me numrin serial të bojës. Mosparaqitja është kusht për s’kualifikim”.** Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori ekonomik “Interlogistic” shpk është s’kualifikuar për arsyet e mëposhtme:

- **Mostrat e dorëzuara nga OE “Interlogistic” nuk plotësojnë kriteret sipas pikës 2.3.3 në DST dhe specifikimeve teknike** “Bojërat duhet të jenë origjinale dhe jo kompatibël, të ricikluar, të rimbushur dhe të kenë pullën e garancisë së prodhuesit të pajisjeve. Te jene te ambalazhuara ne konfeksione te reja, të pahapura e te pademtuara me elementet perkates te sigurise/ vulë origjinaliteti. Emri i prodhuesit duhet të jetë i stampuar si në kutinë e bojës, në pullën e sigurisë si dhe kartrixhe. Numri serial i kutisë duhet të jetë i njëjtë me numrin serial të bojës. Mosparaqitja është kusht për s’kualifikim”. Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit.
- Nuk ka paraqitur “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin, 2019 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar)” ku sipas ekstraktit të QKB OE ushtron aktivitetin edhe në Kamëz për te cilën nuk është paraqitur asnjë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore.

3. Operatori ekonomik “Eldi Qafmolla”Pf është s’kualifikuar për arsyet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik “Eldi Qafmolla” nuk ka plotësuar: a) pikën 2.3.2 te kriterëve te vecanta per kualifikim që bojrat të kenë afat skadence jo më pak se 1 vit nga dita e lëvrimin të tyre dhe shoqërohen me certifikatën e garancisë, b) pikën 2.3.3 “Operatori ekonomik duhet te paraqesë një deklaratë nëpërmjet të cilës të garantojë furnizimin me bojra origjinale të firmave prodhuese ose prodhuesve ekuivalente të paisjeve për printera, fotokopje dhe plotera”; c) pikën 2.3.6 të kriterëve të vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit “Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mallrat që do të dorëzojë do të jenë të njëjtë me mostrat e paraqitura ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit”; d) pikën 2.3.7 të kriterëve të vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit “Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, të të gjithë artikujve të kërkuar në adresën e autoritetit kontraktor”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

4. Operatori ekonomik “Adenis Kastrati Kastrati” shpk është s’kualifikuar për arsyet e mëposhtme:

OE “Adenis Kastrati” “nuk ka paraqitur mostra për artikujt e kërkuar. Nuk plotëson kriteret sipas pikës 2.3.3 në DST dhe pikës 2.3.5 “Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt e kërkuar.....Mosparaqitja e mostrave është kusht për

s'kualifikim". Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik "Erisoni Company" shpk** me adresë: Tirane Njesia Bashkiake nr. 7, Rruga Shefqet Musaraj, Pallati nr. 3, Kati I-re se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **9.387.000 (nëntë milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **9.676.417,3 (nëntë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë presje tre) lekë** pa TVSH, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 17.07.2019

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, janë paraqitur dy ankesa me shkrim në lidhje me vlerësimin e kryer nga ana e KVO-së përkatësisht ankesa e paraqitur pranë AK-së në dt. 19.07.2019 nga operatori ekonomik i renditur në vend të dytë «Interogistic» shpk të cilit i është kthyer përgjigje në datë 25.07.2019 dhe ankesa e paraqitur pranë AK-së në dt. 23.07.2019 nga operatori ekonomik i renditur në vend të parë «Infosoft Office» shpk të cilit i është kthyer përgjigje në datë 29.07.2019 në rrugë elektronike dhe me postë. Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë mori të gjitha masat për pezullimin e procedurës dhe ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për shqyrtimin dhe trajtimin e tyre. Duke qënë se operatorët ekonomikë sa më sipërcituar nuk e kanë ushtruar të drejtën e tyre legjitime për t'u ankimuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik si organi më i lartë për shqyrtimin e ankesave në fushën e prokurimit publik, AK procedoi me hapat e mëtejshme të procedurës.